

# Platforma CiviKos

## STATUTI

Ky statut do të qeverisë shoqatën joftimprurëse Platforma CiviKos, të themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

### Neni 1

#### Themelimi, natyra juridike, emri dhe selia

1.1. Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe avancuar një mjedis të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës.

1.2. Platforma CiviKos është organizatë vullnetare jo-për përfitim, si dhe absolutisht jo-partiake. Emërtimi zyrtar i organizatës është "Platforma CiviKos". Akronim zyrtar i Platformës CiviKos është: CiviKos (në tekstin e mëtejmë do të përdoret vetëm akronimi CiviKos).

1.3. CiviKos ka formë juridike të Shoqatës, në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi për themelimin dhe regjistrimin e Organizatave Joqeveritare në Kosovë.

1.4. CiviKos ka statusin e personit juridik.

1.5. CiviKos ka shenjën e vet identifikuese.

1.6. CiviKos ka xhirologarinë e vet. Çështjet e rregullimit dhe të raportimit finansiar do të definohen me Rregulloren e brendshme të CiviKos [në tekstin e mëtejmë "Rregullorja"], në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

1.7. Adresa e CiviKos është:

Rruja Bedri Pejani 7/A, Prishtinë, Kosovë

1.8. Themelues të CiviKos janë:

- 1) Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile - Venera Hajrullahu
- 2) Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës - Igballe Rogova
- 3) Qendra Kosovare për Studime Gjinore - Luljeta Vuniqi
- 4) OJQ Oaza - Sahit Kandiq
- 5) Rrjeti Rinor i Kosovës - Alban Krasniqi
- 6) Forumi për Iniciative Demokratike - Arbnor Pula
- 7) Community Development Fund - Mirlinda Bunjaku

- 8) Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – Luan Shllaku
- 9) Gjylieta Mushkolaj

## Neni 2

### Parimet drejtuese

- 2.1. CiviKos nuk do t'i shpërndaj asnjë të ardhur neto ose përfitim asnjë personi. Pasuria, të ardhurat dhe përfitimi i CiviKos do të përdoren vetëm për realizimin e planeve, projekteve dhe veprimitarive që kanë për qëllim një mjedis të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës, si dhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e këtij bashkëpunimi.
- 2.2. Çfarëdo transakcioni midis CiviKos dhe anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij, domosdo do të bëhet sipas kushteve më të favorshme për CiviKos.

## Neni 3

### Përfaqësuesi i autorizuar

- 3.1. Përfaqësues i autorizuar i CiviKos është Drejtori Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv emërohet nga Bordi, në pajtim me Rregulloren për punën e Bordit.
- 3.2. Përfaqësuesi i autorizuar i pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të CiviKos.
- 3.3. Përfaqësuesi i autorizuar është përgjegjës për të informuar organin kompetent për regjistrim të organizatave joqeveritare për çdo ndryshim që i bëhet Statutit të CiviKos, si dhe për çdo ndryshim të adresës dhe të numrave të telefonit.

## Neni 4

### Misioni dhe Qëllimet

- 4.1. *Misioni i CiviKos* është krijimi i një mjedisi formal të bashkëpunimit midis sektorit të shoqërisë civile me institucionet shtetërore në Kosovë.
- 4.2. Për realizimin e misionit të vet, CiviKos punon në arritjen e *qëllimeve* në vijim:
  - Formalizimin e kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit midis sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës;
  - Koordinimin e aktiviteteve të organizatave anëtare të cilat synojnë krijimin apo avancimin e një mjedisi të përshtatshëm formal për bashkëpunim të sektorit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore të Kosovës;

## Neni 5

### Veprimtaria

CiviKos do të shfrytëzojë forma të ndryshme të veprimtarisë, me qëllim të përbushjes së misionit dhe qëllimeve të veta, përfshirë seminare, konferenca, takime koordinuese dhe paraqitje mediale. Gjithashtu, CiviKos mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me institucionet shtetërore të Kosovës dhe organizata tjera në rastet kur konsiderohet se marrëdhëniet e tillë ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të CiviKos.

## Neni 6

### Kuvendi i CiviKos, Anëtarësia, Kompetencat dhe Vendim-marrja

6.1. Organi më i lartë drejtues i CiviKos është Kuvendi i të gjithë anëtarëve, respektivisht i organizatave të përfaqësuara nga përfaqësuesit e autorizuar të tyre (në tekstin e mëtejmë "Kuvendi").

6.2. Kuvendi është i vetmi organ kompetent dhe përgjegjës për vendimet që kanë të bëjnë me misionin, qëllimet, drejtimin e zhvillimit, për miratimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe për miratimin e raporteve financiare të CiviKos.

6.3. Kuvendi ka këto kompetenca:

- miraton dhe ndryshon Statutin e CiviKos, me shumicë votash prej 2/3 të anëtarëve prezent;
- miraton Kodin Etik të CiviKos me shumicë votash prej 2/3 të anëtarëve prezent;
- harton dhe miraton Rregulloren për punën e Kuvendit të CiviKos, me shumicë votash të anëtarëve prezent;
- përcakton se a do të kërkohet pagesa e anëtarësisë dhe nëse po, shuma e pagesës, me shumicë votash të anëtarëve prezent;
- zgjedh dhe emëron Bordin e CiviKos me shumicë votash të anëtarëve prezent;
- zgjedh dhe emëron Kryetarin e Kuvendit të CiviKos me shumicë votash të anëtarëve prezent;
- përcakton kompetencat dhe detyrat e Bordit, me shumicë votash të anëtarëve prezent, nëpërmjet Rregullores së Bordit të CiviKos;
- shqyrton dhe miraton të ardhurat, detyrimet, programet, shpenzimet dhe raportet e CiviKos me shumicë votash prej 2/3 të anëtarëve prezent; dhe
- miraton planet vjetore me shumicë votash të anëtarëve prezent.

6.4. Kuvendi vepron gjithmonë në përputhshmëri me misionin dhe qëllimet e CiviKos dhe në pajtim me mandatin e definuar në këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.

6.5. Anëtarët e Kuvendit emërohen nga organizatat e shoqërisë civile, që janë afirmuar për kontributin e dhënë për ngritjen e vlerave demokratike në Kosovë, që e pranojnë Statutin dhe Kodin Etik të CiviKos. Secila organizatë anëtare e autorizon një përfaqësues të saj për të qenë anëtar i Kuvendit të CiviKos. Një person nuk mund të përfaqësojë më shumë se një organizatë.

- 6.6 Bordi, me shumicë votash e bën pranimin e anëtarëve të rinj të CiviKos dhe përkëtë njofton organizatat anëtare brenda një afati prej 10 ditësh nga data e pranimit të anëtarit të ri.
- 6.7. Lista e organizatave anëtare të CiviKos është publike.
- 6.8. Kuvendi i CiviKos, me shumicë votash të anëtarëve prezent, vendos përsuspendimin dhe për përjashtimin e organizatave anëtare nga CiviKos. Procedura përsuspendim, respektivisht për përjashtim të një organizate anëtare nga CiviKos përcaktohet në Rregulloren e Punës së CiviKos.
- 6.9. Përjashtimi, ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë prej 2/3 të votave të anëtarëve prezent. Kundër Vendimit përsuspendim, respektivisht për përjashtim lejohet e drejta e ankesës brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh. Ankesa do të shqyrtohet nga Kuvendi në afat prej 15 ditësh.
- 6.10. Përjashtimisht nga paragrafi 8 i këtij neni, një organizatë anëtare e CiviKos përjashtohet nga CiviKos për shkak të pasivitetit, në rastet e mëposhtme:
1. Në rast se nuk merr pjesë në dy (2) Kuvende të Anëtarëve të njëpasnjëshme; ose
  2. Në rast se nuk merr pjesë në asnjë aktivitet të CiviKos për një periudhë 24 mujore, e cila dëshmohet nëpërmjet listave të pjesëmarrësve të aktiviteteve të CiviKos.
  3. Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasive të CiviKos sipas nënparagrafit 1 të këtij paragrafi niset nga Drejtori Ekzeutiv i CiviKos, pas fillimit të punimeve të Kuvendit të Anëtarëve, si pikë e parë e Rendit të Ditàs të takimit të Kuvendit të Anëtarëve.
  4. Procedurës së përjashtimit të anëtarëve pasivë të CiviKos sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi i paraprin procedura e suspendimit, e cila aplikohet në rast se organizata anëtare nuk merr pjesë në asnjë aktivitet të CiviKos për një periudhë 12 mujore. Suspendimi zbatohet bazuar në procedurat e njejtë me ato të përjashtimit.
  5. Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasivë të CiviKos sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi niset nga Sekretariati i CiviKos në rast se organizata e suspenduar vazhdon të mbetet pasive edhe gjatë 12 muajëve vijues pas suspendimit. Kjo procedurë konfirmohet nga Bordi dhe aprovohet nga Kuvendi, si pikë e parë e Rendit të Ditàs së takimit të rradhës.
  6. Anëtarët pasiv të cilët suspendohen ose përjashtohen me vendim të Kuvendit nuk merren parasysh në llogaritjen e kuroimit për Kuvendin e Anëtarëve të CiviKos në të cilën këta anëtarë përjashtohen.
  7. Në momentin e nisjes së procedurës së suspendimit ose përjashtimit sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi, por jo më pak se shtatë (7) ditë para mbajtjes së Kuvendit të Anëtarëve, Sekretariati i CiviKos obligohet që organizatat anëtare ndaj të cilave fillohet procedura e suspendimit ose përjashtimit t'i njoftojë përkëtë procedurë, në e-mailin zyrtar të organizatës dhe përfaqësuesit të autorizuar. Njoftimi duhet të përmbajë arsyen e nisjes së procedurës së suspendimit ose përjashtimit, së bashku me të drejtën e organizatës anëtare që të dëshmojë aktivitetin e saj.
  8. Procedura e suspendimit ose përjashtimit të një organizate pasive sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi mund të ndërpritet vetëm në rast që organizata anëtare ofron dëshmi të mjaftueshme për aktivitetin e saj në kuadër të CiviKos. Për një veprim të tillë, Drejtori Ekzekutiv i CiviKos njofton Kuvendin e Anëtarëve, duke kërkuar ndërprerjen e procedurës së suspendimit ose përjashtimit të organizatës anëtare.

6.11. Anëtar i Kuvendit nuk merr pjesë në marrjen e vendimeve, si dhe abstenon nga votimi në çështjet në të cilat ajo/ai ka interes personal ose ekonomik.

## Neni 7

### Mbledhjet e Kuvendit

7.1. Mbledhjet e Kuvendit mund të mbahen nëse marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit. Nëse nuk ka kuorum, mbledhja do të prolongohet për ditën e caktuar dhe njoftimi do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve paraprakisht. Çdo anëtar i Kuvendit e ka vetëm një votë.

7.2. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit mbahen së paku një herë në vit. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen kurdoherë që kërkohet nga *gjysma e gjithë anëtarëve të CiviKos*, ose nga Bordi.

7.3. Kërkesa për organizimin e mbledhjeve të jashtëzakonshme duhet t'i drejtohet Bordit, i cili do të njoftojë për mbledhjen të gjithë anëtarët me shkrim.

7.4. Njoftimi për Mbledhjet e Kuvendit, si për mbledhjet e rregullta, edhe per ato të jashtëzakonshmet, duhet të përfshijë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës dhe duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, së paku (*shtatë*) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

## Neni 8

### Bordi i CiviKos

8.1. Bordi i CiviKos zgjedhet nga ana e Kuvendit dhe ka së paku pesë anëtarë. Përmundësinë e rritjes së anëtarëve të Bordit, respektivisht për numrin e anëtarëve të Bordit vendos Kuvendi.

8.2. Për të siguruar vazhdimësi të punës së Bordit, mandati i anëtarëve të Bordit është dy vjet dhe tre vjet, me mundësi rizgjedhjeje.

Procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit përcaktohen me Rregulloren e Bordit të CiviKos, e cila miratohet nga Kuvendi me shumicë votash.

8.3. Anëtar i Bordit nuk merr pjesë në marrjen e vendimeve, si dhe abstenon nga votimi në çështjet në të cilat ajo/ai ka interes personal ose ekonomik.

## Neni 9

### Mbledhjet e Bordit

9.1. Mbledhjet e Bordit mbahen së paku një herë në tre muaj [katër (4) herë në vit]. Sipas nevojës Bordi mund të thërret mbledhje të jashtëzakonshme dhe mund të mblidhet nëse këtë e kërkojnë së paku tre (3) anëtarë të Bordit. Për mbledhjet e jashtëzakonshme, anëtarët e Bordit duhet të njoftohen nga ana e Kryetarit të Bordit, ose Drejtorit Ekzekutiv, së paku 7 (shtatë) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

9.2. Shumica e anëtarëve të Bordit do të përbëjnë kuorumin. Nëse nuk ka kuorum, mbledhja do të prolongohet për ditën e caktuar dhe njoftimi do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve paraprakisht.

9.3. Çdo anëtar i Bordit e ka vetëm një votë.

9.4. Të gjitha vendimet e Bordit do të merren me shumicë votash.

9.5. Secili anëtar i Bordit do të abstenoj nga votimi, nëse për çështjen për të cilën vendoset ajo/ai ka interes personal, apo ekonomik.

9.6. Anëtarët e Bordit nuk do të kenë kompensim material të rregullt mëjor, por me vendim të Bordit mund të përcaktohet që të ju paguhen mëditjet për takimet e mbajtura. Lartësia e mëditjeve do të definohet me Rregulloren e Bordit të CiviKos.

#### Neni 10

##### Pagesa e Anëtarësisë

10.1. Organizatat anëtare të CiviKos obligohen që të paguajnë anëtarësinë në Platformën CiviKos, në një shumë e cila përcaktohen nga Kuvendi i Anëtarëve. Shuma e tarifës së anëtarësimit është e barabartë për të gjitha organizatat anëtare, pavarësisht statusit të tyre financiar apo ndonjë statusi tjeter.

10.2. Pagesa e anëtarësisë bëhet në baza vjetore në fillim të çdo viti kalendarik, por jo më vonë se në datën 15 prill të vitit për të cilin bëhet pagesa e anëtarësisë. Dështimi për të paguar tarifën e anëtarësisë brenda këtij afati sjell përjashtimin automatik të organizatës anëtare nga CiviKos.

10.3. Procedura për përjashtimin e anëtarëve pasivë të CiviKos sipas nënparagrafit 2 të këtij paragrafi niset nga Sekretariati i CiviKos, konfirmohet nga Bordi dhe aprovohet nga Kuvendi, si pikë e parë e Rendit të Ditës së takimit të rradhës.

10.4. Organizatat anëtare të cilat përashtohen me vendim të Kuvendit nuk merren parasysh në llogaritjen e kuroimit për Kuvendin e Anëtarëve të CiviKos në të cilën këta anëtarë përashtohen.

10.5. Jo më vonë se më 1 prill të vitit për të cilin bëhet pagesa e anëtarësisë, Sekretariati i CiviKos obligohet që organizatat anëtare të cilat nuk e kanë bërë pagesën e anëtarësisë t'i njoftojë për obligimin e tyre, në e-mailin zyrtar të organizatës dhe përfaqësuesit të autorizuar. Njoftimi duhet të përmbarë kërkësën për pagesë brenda afatit të paraparë dhe njoftimin rrëth përjashtimit automatik në rast të mos-pagesës brenda afatit të paraparë.

#### Neni 11

##### Pasuria

Të ardhurat e CiviKos mund të përbëhen nga pagesa e anëtarësisë, donacionet në para, kontributet në natyrë, nga trashëgimia, nga dhuratat si dhe nga të ardhurat e

krijuara nga veprimtaritë ekonomike me të cilat në bazë të ligjit ka mundësi të merret CiviKos.

## Neni 12

### Drejtori ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv përfaqëson *CiviKos* dhe është përgjegjës për aktivitetin e përditshëm të saj. Përgjegjësitë dhe kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv do të definoohen qartë në Rregulloren e punës së CiviKos.

## Neni 13

### Punësimi në CiviKos

13.1. Kompetent për marrje të vendimit për hapjen e vendeve të punës është Bordi. Gjithashtu, Bordi mund të përcaktoj që për kryerjen e punëve të caktuara të angazhoj punëtorë të ndryshëm me pagesë.

13.2. Çdo punë e bërë për *CiviKos* për të cilën bëhet kompensim në para, duhet të bëhet në bazë të kontratës me shkrim, e cila duhet të jetë në përputhshmëri me legjislacionin e punës që është në fuqi në Kosovë.

## Neni 14

### Raportimi narrativ dhe financiar

Procedurat për Raportimi financiar brenda *CiviKos*, si dhe midis *CiviKos* dhe institucioneve publike dhe personave të tretë do të definoohen me Rregulloren e Punës të *CiviKos*.

## Neni 15

### Shpërbërja e CiviKos

15.1. *CiviKos* mund të shpërbëhet me vendim të marrë me shumicë votash prej 2/3 të anëtarëve të Kuvendit.

15.2. Me rastin e shpërbërjes, e gjithë pasuria e mbetur e *CiviKos* do t'i transferohet një organizate tjeter kosovare jo-për-përfitim me mision të ngashëm.

15.3. Vendimi për shpërbërjen e *CiviKos* domosdo duhet të përmbytë informacionet në vijim për organizatën të cilës do t'i transferohet pasuria e *CiviKos*: emri, misioni, veprimtaritë, si dhe numri i regjistrimit të organizatës në regjistrat e personave juridik jo-për-përfitim.

## **Neni 16**

### **Viti finansiar**

Viti finansiar i CiviKos përputhet me vitin kalendarik.

## **Neni 17**

### **Ndryshimi i Statutit**

17.1. Statuti i CiviKos mund të ndryshojë vetëm nëse Kuvendi i gjithë anëtarëve vendosë dhe atë vetëm nëse një gjë e këtillë është e domosdoshme përfunksionimin më efikas të CiviKos.

17.2. Ndryshimi i Statutit të CiviKos mund të bëhet me miratim të shumicës prej dy të tretash të anëtarëve të Kuvendit.

Ky Statut është miratuar më datën 16 dhjetor 2015.

16 dhjetor 2015

Kryesuesi i Kuvendit:

Visar Sutaj